


Bibël për fëmijët paraqet



Muri i
Madh i
Nehemias



Shkruar nga: Edward Hughes

Ilustruar nga: Jonathan Hay

Adaptuar nga: Mary-Anne S.

Përkthyer nga: Arianit & Valbona Iljazi

Prodhuar nga: Bible for Children


www.M1914.org

©2013 Bible for Children, Inc.

E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta shtypni këtë histori, nëse nuk do ta shitni.



Persia, një komb i fuqishëm,
sundonte botën. Dhe Mbreti
Artakserks,
sundonte Persinë.
Kjo e bënte atë
sundimtarin më
të fuqishëm
të botës.



Një nga ndihmësit
e rëndësishëm
të mbretit
ishte një burrë
Jude i quajtur
Nehemia.



Puna e tij ishte të provonte
ushqimin e mbretit për ta
mbrojtur atë
nga ndonjë
helmim i
mundshëm.



Një ditë, Nehemia erdhi përpara mbretit me shumë trishtim që i tregohej në fytyrë. Mbreti donte të dinte arsyen e trishtimit të Nehemias.



"O mbret, jetofsh përjetë", tha
Nehemia.



“Unë jam i trishtuar, sepse qyteti
ku janë varrosur etërit e mi, është
në gërmadha dhe dyert e tij janë
djegur”.



Nehemia po fliste për Jerusalemin,
që ishte shkatërruar nga lufta
shumë vite më parë.




Mbreti Artakserks pyeti, "Çfarë dëshiron të bësh"? "Më jep leje për të shkuar në Jerusalem për ta rindërtuar", iu lut Nehemia.



Mbreti Artakserks me shumë kënaqësi pranoi. Për më tepër, ai i dha Nehemias letra zyrtare për mbrojtjen e tij gjatë udhëtimit.



Mbreti ndihmoi edhe më shumë. Ai i dha Nehemias një letër për Asafin, rojtarin e pyjeve të mbretit.



Urdhëri për Asafin ishte që ta furnizonte Nehemian, me të gjithë lëndën drusore që do ti nevojitej për ndërtimin e mureve të qytetit.




Kur Nehemia mbërriti në Jerusalem,
ai mblodhi zyrtarët e qytetit dhe
u tha, "Jemi në telashe këtu.



Qyteti është në gërmadha, dhe dyert e tij janë shkruar. Le të fillojmë rindërtimin".



Ai u tha atyre, se Mbreti Artakserks kishte dhënë aprovimin e tij, dhe përmbi të gjitha Perëndia ishte në anën e tyre.



Besimi dhe entuziazmi i Nehemias i frymëzoi njerëzit.



Ata pranuan, duke thënë, "Le të rindërtojmë". Nehemia i tregoi çdo familjeje, se cilën pjesë të murit duhej të riparohet.



Por, jo të gjithë dëshironin
ndërtimin e mureve.



Një njeri i quajtur Sanballat, dhe
dy shokët e tij Tobia
dhe Geshemi, ...



... nuk ishin Judenj; ata nuk
dëshironin që muret
të ndërtoheshin dhe
as që



dyert të
rregulloheshin.



Ndërsa puna vazhdonte, Sanballati u zemërua shumë. Ai dhe shokët e tij, i tallnin Judenjtë.




Tobia tha, "Kur ata të mbarojnë këtë farë muri, një dhelpër e vogël do ta rrëzojë". Nehemia nuk u përgjigj.



Përkundrazi, ai u lut që të ishte
Perëndia, Ai që të merrej me këta
njerëz të ligj.



Kur fyerjet e tyre tallëse nuk patën
asnjë rezultat, ...



... ata bënë një komplot që të
luftonin kundër Jerusalemit
dhe të bënë rrëmujë
sa më shumë që të
mundeshin.



Përsëri, Nehemia iu lut Perëndisë për ndihmë. Ai gjithashtu, vuri roje ditë e natë, që të mos ziheshin në befasi.



Judenjtë punonin
aq shumë, sa po
rraskapiteshin.
Disa druheshin
se armiqtë
do ti sulmonin
dhe vrisnin
ndërsa ata
punonin.



Megjithatë, Nehemia nuk e ndaloi punën. Ai vuri roje rreth punëtorëve dhe u kujtoi atyre që Perëndia ishte me ta, dhe Perëndia është më i fortë se armiku!



Nehemia,
u përpoq të
jetë shembulli
i përsosur.



Mbreti
Artakserks,
e kishte
bërë atë
qeveritar të
Jerusalemit, ...



... me të drejtë
për të kërkuar
ushqim dhe
para nga
njerëzit; por
Nehemia
nuk e
bëri



këtë.




Përkundrazi ai
jo vetëm që
punoi përkrah
ndërtuesve të
mureve, ...




... por edhe
shpenzoi vetëm
nga paratë e tij
për të blerë
ushqimin që i
nevojitej.



Më në fund njerëzit e mbaruan punën e mureve, dhe vetëm dyert kishin mbetur për tu vendosur në portat kryesore.



Kur Sanballati, Tobia dhe Geshemi
dëgjuan që të gjitha të çarat ishin
riparuar, ata vendosën ta vrasin
Nehemian.



Ata dërguan mesazhe për Nehemian,
që të takoheshin në një vend të
quajtur Ono. Por Nehemia e dinte
që ata po përpiqeshin ta mashtronin,
për ta nxjerrë nga
qyteti dhe për
ta vrarë.




Ai u dërgoi atyre një letër duke iu përgjigjur se nuk mund të linte punën për tu takuar me ta.



Më në
fund muri

u



rindërtua dhe
Nehemia ...






... vendosi roje për
ta mbrojtur.



Ai
gjithashtu



urdhëroi, që dyert
e qytetit ...




... të mos
hapen



përpara lindjes
së diellit.



Dyert
duhet të



qëndronin të
mbyllura ...



... dhe të
kyçura
mirë



përgjatë
gjithë natës.



Tani që qyteti ishte i sigurtë,
shumë prej Judenjve të
internuar
në
vende të
tjera të
botës u
kthyen
në
Jerusalem.



Nehemia e ndjente veten tepër të lumtur që kishte mundur të mbaronte punën për të cilën Perëndia e kishte dërguar; ...



... pavarësisht gjithë
vështirësi.



Për aq kohë sa qëndroi në
Jerusalem, ...



... Nehemia e nxiti popullin
vazhdimisht që ti bindej Perëndisë.



Muri i Madh i Nehemias

Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla

e marrë nga

Nehemias

"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u
jep mendje njerëzve të thjeshtë."

Psalmet 119:130



Fund



Ky tregim nga Bibla na tregon për Perëndinë tonë të mrekullueshëm i cili na krijoi dhe dëshiron që ne ta njohim Atë.

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan mëkate. Dënimi për mëkatin është vdekja, por Perëndia ju do juve aq shumë sa që dërgoi Birin e Tij të vetëm, Jezusin, që të vdesë në Kryq dhe të dënohet për mëkatet tuaja. Pastaj Jezusi u ringjall dhe u ngrit lart në Qiell! Nëse beson në Jezusin dhe i kërkon Atij të t'i falë mëkatet e tua, Ai do ta bëjë atë! Ai do të vijë dhe do të jetojë në ty, dhe ti do të jetosh me Të përgjithmonë.



Nëse ti beson se kjo është e
vërteta, drejtoju Perëndisë kështu:
Jezus i dashur, unë besoj se Ti je Perëndia i
bërë njeri për të vdekur për mëkatet e mia,
dhe që Ti u ngjalle sërish. Të lutem, eja në
jetën time dhe fal mëkatet e mia, në mënyrë
që unë të kem jetë të re dhe një ditë të jem
me Ty, përgjithmonë. Më ndihmo, të të bindem
dhe jetoj për Ty, si fëmija Yt. Amen.

Lexo Biblën dhe bisedo me Perëndinë
çdo ditë! Gjoni 3:16

